

# Hylli i Dritës

*Ubi Spiritus Domini, ibi libertas.*

(II. ad Cor. III. 17).

---

1. Morali i shtetit e morali fetar nuk janë thikë e brisk	Fq. 481
2 Spiritizmi në dritë t' arsyës	„ 492
3. Shkrimtari më i vjetri i italo-Shqyp- tarvet, Lukë Matranga (1592)	„ 505
4. Lahuta e Malcis (Turgut Pësha)	„ 523
5. Dy Pasqyra Letratyre	„ 520
6. Per „Visarin komtar“	„ 537

---

SHKODER

Shtypshkroja Françeskane

1931.



## Morali i shtetit e morali fetár nuk janë thikë e brisk.

Na shqyphtarët, sod të thuesh, po e fillojm jeten shoq-  
nore e kulturele, d. m. th. tash po fillojm me mendue e me  
punue të ngallnojn në vendin t' onë njato idé e njato pa-  
rime, mbas të cillavet, të mujmë me i plotsue mâ së miri të  
gjitha nevojët e jetës në setcillen pikpamje e kështû të lum-  
nojm porsi vehtje edhë porsi kolektivitet.

Po u râm në të këtyne pârimeve themelore, — nuk  
thomi, se me kaq âsht ndreqë e sigurie lumnija e jetës shqyp-  
tare, por — pá farë dyshimi, — âsht krijue njaj organizem i  
shndoshtë, prej kahë do të dikojn njato vepra vigane, qi ly-  
pen per ndertesen e kulturës shqyptare; per kundra po e vûm  
keq gurin e themelit, per mot e jetë ká me vue edhë jeta e  
jonë civile e kombtare. Çë do gabim a errsí në ket punë âsht  
nji krim e krim i madh.

Jeta pá kurrfarë qellimi nuk âsht jetë nierzore; pá nji  
ideal s' kemi çë t' a bâjm të gjallët, as s' i a vije mundi të  
rrnojm e të bâjm hije mbí tokë; porse nieri, — si i thonë  
nji fjalës — nuk rrnon nder rê as s' ushqehet vetun me ajr;  
per lumnín e nierit, posë idealit, lypet plotsimi i egzigencavet  
jetsoro, pse kúr nevojët e jetës të na vên nen veti e mos të  
na lânë me pá dritë as diell, jeta e jonë âsht nji lngim i pa-

